REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 731/20
Datë/Datum. 09.11.20
PRISHTINE - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	**09 NENTOR 2020**
REFERENCË:	**731/20**
PËR/ZA/TO:	AK- Qendra e Studenteve
NGA/OD/FROM:	**Blerim Dina - Kryetar i OSHP-së**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**NJOFTIM**

Operatori ekonomik - **"Osa Termosistem"sh.p.k -Rahovec**, si palë e pakënaqur me datën: 29.09.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 731/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ***"Furnizim me paisje industriale per kuzhine",*** me nr.të prokurimit: 1020890500-20-4709-1-2-1, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- 6, 7, 19, 28, 44 dhe 108/A të LPP-së
- Pika 20.8 I legjislacionit sekondar A01 Rregullat dhe Udhezuesi Operativ për PP

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 14 Tetor 2020 kanë autorizuar eksperten shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit me datën 26 Tetor 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Te anulohet ne tërësi aktiviteti i prokurimit dhe nëse AK, ende ka interes te njëjtin ta **RI TENDEROJ**.

Autoriteti kontraktues- **"Qendra e Studenteve"** me datën 26 Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertes shqyrtuese të prokurimit dhe të njëjtit me datën 27 Tetor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës për anulim te proceduese dhe me pastaj te bëjë RI-TENDERIM sepse këto furnizime me pajisje për kuzhinë janë shumë te nevojshme për fillimin e vitit te ri akademik .

Operatori ekonomik ankues – **"Osa Termosistem"sh.p.k -Rahovec** me datën 26 Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertes shqyrtuese dhe të njëjtit me datën 29 Tetor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës .

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues - **"Qendra e Studenteve"** për aktivitetin e prokurimit ***"Furnizim me paisje industriale per kuzhine",*** me nr.të prokurimit: 1020890500-20-4709-1-2-1, të aprovohet si e bazuar. Te anulohet ne tërësi aktiviteti i prokurimit dhe nëse AK, ende ka interes te njëjtin ta **RI TENDEROJ**, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik **"Osa Termosistem"sh.p.k -Rahovec** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.